



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 146, datë 28.09.2023

**PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË ANEKSIN 1, BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 63, DATË 17.03.2023, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA”, PALLATI NR. 130, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit” i ndryshuar me Urdhërin 222, datë 06.07.2020, Raportit me nr. 8551/1 prot., datë 15.09.2023 të Komisionit të Posaçëm si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e disa shtesave në Aneksin 1 bashkalidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 63, datë 17.03.2023, i ndryshuar, përsa i përket listës së përfituesve për pallatin nr.130 rruga “Aleksandër Goga”, në Njësinë Administrative nr.4, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
21	NAXHIRE LAPI	6	3+1
22	LULJETA ABDYLI, PETRIT ABDYLI	2	1+1

2. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 17.03.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr.4, rruga “Aleksandër Goga”, pallati nr.130, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019” duke hequr nga lista përfituese nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr.4, rruga “Aleksandër Goga”, pallati nr.130, të subjektit përfitues:

- Z. Xhevdet Çullhaj, Naxhije Çullhaj listuar në Aneksin 1 me numër rendor 12.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**


**U shpall sot me datë 29.09.2023**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 629/4 Prot.

Durrës, më 05.10.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.146 datë 28.09.2023 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 17.03.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative nr.4, rruga “Aleksandër Goga”, pallati nr.130, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

